



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1536/prot.
2

Tiranë, më 24.09.2026

SHPALLJE

PËR NEVOJËN PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Mbështetur në nenin 8 të ligjit Nr.8/2023 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”, Urdhërit të Kryeministrit Nr. 120, datë 19.06.2026 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, nenit 5 dhe nenit 6 të të Udhëzimit nr. 1, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përmbaruesit gjyqësor shtetëror”, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit njofton përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë për nevojën për transferim të përkohshëm në **Zyrën Përmbarimore Vendore Mat**, si rrjedhojë e vakancës së krijuar nga transferimi i përhershëm i përmbaruesit gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Kurbin. Për shkak të kësaj situate, paraqitet nevoja për garantimin e vazhdimësisë së ushtrimit të funksionit përmbarimor dhe të përmbushjes së detyrave funksionale pranë kësaj zyre, nëpërmjet transferimit të përkohshëm të një përmbaruesi gjyqësor shtetëror.

- Transferimi i përkohshëm do të kryhet në **Zyrën Përmbarimore Vendore Mat**.
- Periudha e transferimit të përkohshëm parashikohet të jetë **jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj**, në varësi të nevojës dhe situatës konkrete të Zyrës Përmbarimore Vendore Mat.
- Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë që janë të interesuar për transferim të përkohshëm në Zyrën Përmbarimore Vendore Mat, ftohen të paraqesin **pëlqimin e tyre me shkrim**.
- Pëlqimi duhet të paraqitet brenda datës **01.10.2026**, ora **16:00**.
Afati i mësipërm është jo më i shkurtër se 7 ditë kalendarike nga publikimi i këtij njoftimi, datë **24.09.2026**, në përputhje me nenin 5, pika 3, shkronja “ç”, të Rregullores.

- Pëlqimi me shkrim duhet t'i bashkëlidhet dokumentacioni shoqërues, i cili nuk mund të administrohet kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, konkretisht:

- pëlqimi i shprehur me shkrim për transferim të përkohshëm;

[dokumentacioni tjetër, nëse kërkohet].

- Pëlqimi dhe dokumentacioni shoqërues duhet të paraqiten në:

Adresën postare Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
Sheshi "Qemal Mustafa Atatürk", Tiranë
ose në adresën elektronike: info@dpp.gov.al

- Transferimi i përkohshëm, si rregull, kryhet me pëlqimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror që transferohet. Në rast se, brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim, **asnjë përmbarues gjyqësor shtetëror nuk paraqet pëlqimin për transferim**, transferimi i përkohshëm mund të kryhet edhe pa pëlqim, në përputhje me nenin 6, pika 2, të Rregullores.
- Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe u dërgohet në adresat elektronike përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë që mund të transferohen përkohësisht.

Data e publikimit: 24.09.2026

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

